



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 136, Datë 12.06.2020.

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT

Në mbështetje të nenit 143, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 189/1/c, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 34, dt. 10.04.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe në nenin 8, të Vendimit nr. 26, dt. 22.02.2019, “Rregullore për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie) për prokurorin Ylli Pjetërnikaj, si pedagog me kohë të pjesshme pranë Departamentit të të Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në lëndën “E drejta penale e posaçme”, në masën dy orë në javë, çdo ditë të Mërkurë, nga ora 14.00 deri në orën 16.00, për vitin akademik 2020-2021.
2. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie) për prokurorin Ylli Pjetërnikaj, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Kolegji Universitar TBU (Tirana Business University College), në lëndën “Procedura Penale”, në masën 60 orë, të shpërndara në 30 javë, 15 orë për çdo semestër, deri në dy orë në javë, çdo ditë të Enjte, pas orës 17.30, për vitin akademik 2020-2021.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Ylli Pjetërnikaj dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI


ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTARE
ESMERALDA CAMI KESHI



ANËTARE
NURIHAN SEITAJ



ANËTAR
TARTAR BAZAJ



ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
VATË STAKA

